



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 nëntor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W04393 përmes
Videokonferencës**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2) e (4)(f), 23(1) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 141(1) dhe 144 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 8 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi kërkesë ku kërkonte autorizimin e Trupit Gjykues që dëshmia e W04393-shit të merret përmes videokonferencës nga një vend i përshtatshëm ("Kërkesa").¹ ZPS-ja parashtroi se, për shkak të rrethanave personave të dëshmitarit, dhënia e dëshmisë përmes videokonferencës: (i) do të garantojë mirëqenien fizike dhe psikologjike të dëshmitarit; dhe (ii) nuk do t'u shkaktojë dëm të papërligjur të akuzuarve, duke qenë se Mbrojtja do të jetë plotësisht në gjendje ta marrë në pyetje dëshmitarin.²
2. Më 23 tetor 2024, Zyra Administrative dorëzoi vlerësimin e vet për Kërkesën dhe konfirmoi mundësinë e realizimit të dhënies së dëshmisë nga dëshmitari në fjalë përmes videolidhjes ("Vlerësimi i Zyrës Administrative").³
3. Mbrojtja nuk dorëzoi përgjigje.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas rregullës 141(1), në parim, dëshmitarët e japin dëshminë e tyre në gjyq duke qenë të pranishëm. Trupi Gjykues gjithashtu mund të lejojë dhënien e

¹ F02627, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W04393 përmes Videokonferencës*, 8 tetor 2024, konfidenciale, para. 1 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02627/RED).

² Kërkesa, para. 2, 6-8.

³ F02670, Zyra Administrative, *Vlerësim i Zyrës Administrative lidhur me Kërkesën e Prokurores së Specializuar për Dhënie të Dëshmisë nga W04393 përmes Videokonferencës*, 23 tetor 2024, konfidencial dhe ex parte, para. 16.

dëshmisë nëpërmjet videokonferencës sipas rregullës 144 në një mënyrë që nuk shkakton padrejtësi, apo që nuk është mospërputhëse me të drejtat e të akuzuarit.

5. Sipas rregullës 144(1) dhe (3), Trupi Gjykses mund të urdhërojë që dëshmia të jepet me videokonferencë, me kusht që nëpërmjet kësaj mënyre dëshmitari të pyetet si duhet. Trupi Gjykses garanton që videokonferenca t'u mundësojë palëve dhe Trupit Gjykses t'i bëjnë pyetje dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë.

III. DISKUTIM

6. Trupi Gjykses rikujton se ka kompetencë diskrecionale të autorizojë dhënien e dëshmisë përmes videokonferencës kur përmbushen kriteret e rregullës 144, edhe pse prania e dëshmitarit në gjykatë mbetet opsioni i preferuar.⁴

7. Trupi Gjykses thekson se, gjatë shqyrtimit nëse të lejohet dhënia e dëshmisë përmes videokonferencës, mund të merren parasysh disa faktorë, përfshirë: (i) vendi; (ii) rrethanat personale dhe shëndetësore të dëshmitarit; (iii) disponueshmëria dhe siguria e dëshmitarit; dhe (iv) kompleksiteti dhe kohëzgjatja e çdo udhëtimi logjistik dhe përgatitjet e tjera që duhet të bëhen.⁵

8. Pasi shqyrtoi me kujdes Kërkesën dhe duke mbajtur parasysh se Mbrojtja nuk ka kundërshtime, Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar që rrethanat personale dhe shëndetësore të dëshmitarit përlligjin dhënien e dëshmisë përmes videokonferencës. Trupi Gjykses mban parasysh veçanërisht: (i) moshën dhe rrethanat shëndetësore të W04393-shit; (ii) faktin se dëshmia përmes

⁴ *Shih p.sh.* F02572, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënie të Dëshmisë nga W02135 përmes Videokonferencës dhe Kërkesën lidhur me Të* ("Vendimi i 13 shtatorit 2024"), 13 shtator 2024, para. 5; KSC-BC-2020-07, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 2-5. *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-T, Trial Chamber II, [Decision on the Defence Motions to Summon and Protect Defence Witnesses, and on the Giving of Evidence by Video-Link](#), 25 June 1996, para. 19.

⁵ *Shih p.sh.* Vendimin e 13 shtatorit 2024, para. 5; KSC-BC-2020-07, transkriptin e seancës, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 6-10. *Shih për ngjashmëri* KSC-BC-2020-04, F00482/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Dëshmi përmes Videokonferencës për TW4-04-ën, TW4-10-n dhe TW4-11-shin*, 13 prill 2023, para. 13-14.

videokonferencës është më e favorshme për mirëqenien e W04393-shit sesa transferimi i dëshmitarit në Hagë për të dëshmuar në sallën e gjyqit; (iii) kuadrin, llojin dhe kohëzgjatjen e kufizuar që pritet të ketë dëshmia e W04393-shit (një orë); (iv) kryerjen e shpejtë të procesit; dhe (v) aftësinë e dëshmitarit për të dhënë dëshmi me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur.

9. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se dhënia e dëshmisë nga W04393 përmes videokonferencës nuk do t'u shkaktojë dëm të akuzuarve dhe është në përputhje me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të tyre, duke qenë se W04393 do të merret në pyetje në kushte të njëjta si të ishte në sallën e gjyqit. Konkretisht, Trupi Gjykses, të akuzuarit, palët dhe dëshmitarët do të jenë në gjendje të shohin dhe të dëgjojnë dëshmitarin duke dhënë dëshmi drejtpërdrejt dhe do të kenë mundësi t'i bëjnë pyetje.

10. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh edhe Vlerësimin e Zyrës Administrative se është e realizueshme dhënia e dëshmisë nga W04393 përmes videokonferencës nga një vend i përshtatshëm me përgatitjet e nevojshme logjistike, teknike dhe të sigurisë, përfshirë zbatimin e masave mbrojtëse në sallën e gjyqit.⁶

11. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesën e ZPS-së dhe autorizon që dhënia e dëshmisë nga W04393 të bëhet përmes videokonferencës.

IV. KLASIFIKIMI

12. Trupi Gjykses vëren se Vlerësimi i Zyrës Administrative është dorëzuar si konfidencial dhe *ex parte*. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të dorëzojë versionin e redaktuar konfidencial dhe/ose versionin e

⁶ Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 7-14, 16.

redaktuar publik të Vlerësimit të Zyrës Administrative deri **të martën, 12 nëntor 2024**.

V. VENDIM

Për arsytet e sipërpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **AUTORIZON** W04393-shin të japë dëshmi përmes videokonferencës;
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të bëjë përgatitjet e nevojshme për dhënien e dëshmisë nga W04393 përmes videokonferencës; dhe
- d) **URDHËRON** Zyrën Administrative të dorëzojë versionin e redaktuar konfidencial dhe/ose versionin e redaktuar publik të Vlerësimit të Zyrës Administrative jo më vonë se **të martën, 12 nëntor 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 6 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë.